

MINISTRE E INTERGRIMIT NUK MUND TA MANIPULOJË z. STEFAN FULE DHE BE PËR PRONAT

Media njoftoi se znj. Majlinda Bregu ministre e intergrimit i dorëzoi Komisionerit Stefan Fyle raportin e Qeverisë për 12 kërkesat e BE. Ne nuk dimë se çfarë është raportuar për pronën ku ka vetëm regres. Pas vërejtjeve të përsëritura të BE dhe Raportit 2011 të Avokatit të Popullit pronarët prisnin që maxhoranca të propozonte një ligj sipas të cilit shteti merr përsipër detyrimin të zbatojë të drejtën e pronësisë në përputhje me Kushtetutën. Varianti më i thjeshtë dhe më llogjik do të ishte që Qeveria të fillonte të kthente pronat e grabitura nga komunizmi, duke filluar me tokat e ish Ndërmarrjeve Bujqësore ku dhe shkeljet janë shumë të mëdha. Këto shkelje janë konstatuar nga institucionet e shtetit, por Qeveria bëri të kundërtën duke propozuar përkeqësimin e ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim të tokës bujqësore” dhe të ligjit 9235. Këto qëndrime, janë hapa prapa me pronat. Ministrat Genc Ruli dhe Genc Pollo që propozuan për këto hapa prapa u justifikuan me “rregullimin e situatës juridike, për familjet bujqësore apo individët, subjekte të përfitimit të tokës bujqësore që e përdorin pronën, por që për shkaqe të ndryshme nuk ishin pajisur me tituj pronësie”. Zoti Berisha duhet të dokumentojë se ku e gjeti dhe si e ka fituar Qeveria apo Shteti, të drejtën e pronësisë për këto prona, pronën e kujt po falin apo po transferojnë tek të tretët këto dy projekligje.

Ne denoncojmë këtë politikë, që duke mos bërë dallimin se cilat janë pronat e shteti dhe cilat janë pronat e grabitura që shteti duhet t’ja kishte kthyer pronarëve që në vitin 1991, praktikisht vjedh pronat në emër të ligjit ashtu siç ka orientuar platforma e Katovicës. Relaisht ky është mentaliteti antipronar dhe papërgjegjshmëria e Kryeministrit Berisha që me këto dy vendime e thellon anarkinë me pronat që ka nisur që në vitin 1991 dhe ai ka përgjegjësinë kryesore për pasojat ekonomike dhe sociale si dhe refuzimin që po i bëhet Shqipërisë si vend kandidat në BE. Por çfarë force e shtyn Kryeministrin në këtë rrugë kaq antikombëtare dhe antikushtetuese ? Pak më parë në gazetën “Shqip” zoti Luan Pobrati (një nga shefat e sigurimit të shtetit në kohën e diktaturës), i kërkonte Kryeministrin Sali Berisha, të largojë nga drejtimi agjentët e shërbimeve të huaja, që me siguri ai i njeh. Ka mundësi që këta persona që z. Pobrati nuk bëri publike të jenë personat që në 1991 instaluan anarkinë e pronës dhe vazhdojnë ta mbrojnë atë me të gjitha mënyrat.

Kuvendi i Shqipërisë që do të vlerësojë këto propozime duhet të ketë parasysh se VKM nr. 452, datë 17.10.1992, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, dhe më pas me VKM

nr. 161, datë 8.4.1993, janë dy VKM të miratuara në vitet 1992-93, që nuk kanë asnjë bazë ligjore. Gjatë këtyre 18 vjetëve këto vendime janë përkeqësuar në dëm të pronarëve të ligjshëm dhe anarkia e pronës është rruga e gabuar e Sali Berishës që i ka shkaktuar plagë të shumta popullit. Shoqata e Pajtitit të Gjakrave, për konflikte prone ka raportuar mbi 6000 të vrarë dhe 5000 familje të ngjuara Të shohim nëse Kuvendi do ti miratojë këto ligje që shkelin të drejtat e njeriut të përcaktuara qartë në dispozitat Kryesore Kushtetuese në 1991 dhe janë të saktësuara edhe më mirë në nenet 41 dhe 181 të Kushtetutës së 1998. Rikujtojmë çdo deputet që e ndjen veten patriot, të mos votojnë këto ligje. Shumë mirë që deputetët janë sensibilizuar për të mbrojtur të drejtën e çamëve për pronat e tyre në Çamëri, nuk kjo nuk mund të kërkohet duke shkelur të drejtën e pronave për shtetasit brenda kufirit të Shqipërisë. Kthimi fizik i pronës tek i zoti dhe jo gënjeshtër me kompensim është zgjidhja e kërkuar që redukton këtë burim të korrupsionit të administratës shtetërore, veçanërisht asaj që merret me kthimin e pronave, pakëson korrupsionin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe të zyrtarëve të lartë të Ministrisë së Drejtësisë, ku papërgjegjshmëria arrin kulme. Kjo papërgjegjshmëri shkon deri aty sa Avokati i Shtetit e mashtron Strasburgun, duke raportuar se vendimet e Gjykatës së Strasburgut janë ekzekutuar kur në fakt ato nuk janë ekzekutuar.

Ambasadorët dhe veçanërisht ata të BE, OSBE, SHBA, B. Botërore, OSBE etj e kanë shumë të qartë se vetëm duke u kthyer prona tek i zoti do të pakësohet anarkia e pronës, duke plotësuar kërkesën më kryesore për pranimin e Shqipërisë si kandidat të BE.

Po ashtu duhet arsyetuar se bëhet fjalë për pronarë të ligjshëm që sllavokomunizmi i ka grabitur i ka burgosur, i ka persekutuar dhe denigruar për 45 vjet dhe kësaj vuajtje politikanët pseudodemokratë i shtojnë edhe 20 vjet vuajtje dhe dhunë nga postkomunizmi. Problemi nuk ka shumë palë por ka vetëm dy palë: Pala grabitëse, që është Shteti me detyrimin të zbatojë të drejtat e njeriut dhe Kushtetutën dhe palën e grabitur ose pronarin ë po pret të zbatohet Kushtetuta. **Prona që duhet të kthehet është e përcaktuar qartë me dokumentat e shtetëzimit që shteti i ka në zyrat e kadastrave dhe arkivat shtetërore. Nga këto prona, duhen kompensuar vetëm ato prona që deri në 1991 janë tjetërsuar për godina banimi dhe ato që shfrytëzohen për nevoja publike.** Palët e tjera që pretendohen si palë të interesuara që shpesh i kemi dëgjuar edhe nga persona të respektuar ne i shikojmë si produkt i konceptimeve të gabuara, **produkt i ndikimeve agjenturore dhe i interesave klanore Rruga që po ndiqet është vjedhje dhe bie ndesh me Kushtetutën dhe të drejtat e njeriut.**

Kundërshtimi që bëri në media zv kryetari Partisë Republikane për faktin se në hartimin e këtyre ligjeve nuk u muar qoftë sa për sy e faqe mendimi shoqatës, duhet lavdëruar por realisht pronarët dhe shoqata nuk kanë se si ta besojnë klanin Republikan sepse në këto 20 vjet postkomunizëm deputetët republikanë, kanë qenë kolona e pestë që ka shtuar realizimin e të drejtës kushtetuese të pronarëve për të gëzuar pronën e tyre. Gazeta Republika shkruan vetëm për kompensimin. Kjo gazetë prej shumë vjetësh nuk ka shkruar asnjë shkrim për shkeljen e nenit 181 të Kushtetutës dhe nuk ka botuar asnjë shkrim të shoqatës Pronësi me Drejtësi. Prandaj tani që po dëgjoj republikanët të deklarojnë në ekrane se janë të shqetësuar për pronarët tani kur po afrojnë zgjedhjet, mua më kujtohen lotët e krokodilit dhe i kujtoj atyre atë këngën korçare “të tjera bën të tjera thua”... Klani Republikan mund të mashtrojë vetëm ata të huaj, që ju intereson të besojë se problemi e pronës do të zgjidhet me kompensime që juridikisht janë shkelje e kushtetutës. Me kohë ja kemi thënë publikisht republikanëve dhe gjithë politikanëve se në këto 20 vjet deputetët që kanë penguar kthimin e pronës tek i zoti, janë pjesë e interesave të errëta të klaneve antishqiptare dhe agjenturave të huaja. Kryetari i Partisë Republikane, duhet që paraprakisht të kërkojë falje për dëmin e madh që i kanë shkaktuar demokracisë në këto 20 vjet, duke luajtur rolin e dyfishtë në dëm të pronarëve të ligjshëm.

Për të dalë nga kjo situatë, ne kërkojmë ndihmën e Avokatit të Popullit, që ai të mbrojë të drejtat e shtetasve për pronën e tyre të trashëguar.

Duke shprehur besim tek institucioni i Avokatit të Popullit kërkojmë që ai të sqarojë delegacionet e KE dhe BE që do vizitojnë Shqipërinë për faktin se politikanët nuk duan ta kthejnë pronën tek i zoti, se problem Nr. 1 për shoqërinë shqiptare është prona dhe jo të drejtat e gey-ve, se treguesit e respektimit të pronës janë nga më të ulëtat në Botë dhe se pa ndërhyrjen e tyre kriza e pronës do ndërlikohet me kriza të tjera.

Kërkojmë nga Avokati i Popullit të sqarojë dhe rekomandojë ambasadorët e BE , OSBE dhe SHBA, që të mos bëhen mbështetës të politikave që nuk respektojnë të drejtën e pronës dhe që të mos vazhdojnë të keqpërdoret mbështetja e ndërkombëtarëve ata nuk duhet të mjaftohen me qëndrimin vëzhgues si deri tani, siç ka deklaruar zoti Stefan Fyle, por të jenë konkretë në kushtëzimin dhe veprime konkrete për ta detyruar Qeverinë të kthejë pronat tek i zoti ashtu siç i ka garantuar kushtetuta në vitin 1991 dhe i ka saktësuar kushtetuta e 1998.

Rrapo Hajredin Danushi

Kryetar i Shoqatës Kombëtare të të Shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi”